

Vendim nr. 232 datë 24.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 24.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (D) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **DARLIN PREZA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-513 (37), datë 29.01.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është njohur me dëshmi trashëgimie nr. rep. 3786, nr. kol. 1166, datë 10.09.2021, si trashëgimtar i ligjshëm i një pjese të pasurisë të të ndjerit A.T. (*paditësi*). Ky i

fundit rezulton, ndër të tjera, pronar dhe bashkëpronar i disa sipërfaqeve trualli dhe ndërtesa në qytetin e Tiranës, të cilat i ka dhënë me kontratë sipërmarrjeje për ndërtimin e disa pallateve dhe një shkolle private shoqërisë “H.” sh.p.k. Shoqëria “H.” sh.p.k., pasi ka kryer shembjen e objekteve, ka vijuar ndërtimin e një objekti shumëkatësh pa u pajisur me leje ndërtimi nga organet kompetente. Shtetasi A.T. me anë të njoftimit të datës 09.07.2007, drejtuar shoqërisë “H.” sh.p.k., i ka deklaruar kësaj të fundit anulimin e kontratës për shkak se nga ana e saj po punohej mbi truallin në pronësi të tij pa leje ndërtimi. Në kushtet kur ndërtimi ka vijuar duke u legalizuar më pas në vitin 2013, A.T. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi ndaj shoqërisë “H.” sh.p.k., duke kërkuar zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes, pagesën e dëmit dhe fitimit të munguar, pagesën e qirasë për të gjithë periudhën, si dhe sigurimin e padisë, duke bllokuar pasuritë dhe llogaritë e palës së paditur.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6727, datë 28.06.2012, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, duke vendosur detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit vlerën e dëmit të shkaktuar për efekt të mungesës së lejes së ndërtimit në masën 219,066 euro, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të saj. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim si paditësi ashtu dhe pala e paditur. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 851, datë 9.4.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 6727, datë 28.06.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

3. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3284, datë 21.04.2015, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë dhe detyrimin e palës së paditur të paguajë në favor të paditësit shumën prej 1,541,835 eurosh, detyrimin e palës së paditur të paguajë kamatat ligjore për këtë shumë nga data e paraqitjes së padisë dhe në vazhdim deri në datën e ekzekutimit të vendimit, si dhe detyrimin e palës së paditur që të paguajë në favor të paditësit vlerën që do të përfitonte nga dhënia me qira e objekteve që rezulton të ketë qenë në pronësi të këtij të fundit në shumën 25,596,400 lekë, si dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim si paditësi, ashtu edhe pala e paditur.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 678, datë 21.03.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit gjyqësor nr. 3284, datë 21.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për rekursin e paraqitur nga shoqëria “H.” sh.p.k., Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-513 (37), datë 29.01.2025, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 678, datë 21.03.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me tjetër trup gjykues.

5. Në datën 09.07.2025 kërkuesi, në cilësinë e trashëgimtarit të shtetasit A.T., ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuessit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

6.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

6.1.1. *Së drejtës së aksesit të lidhur me mbrojtjen efektive*, pasi Kolegji Civil nuk ka kryer kalim procedural duke mos njoftuar në këtë mënyrë trashëgimtarët e ligjshëm të paditësit dhe duke u mohuar atyre të drejtën për të dhënë parashtrime dhe për t'u mbrojtur në atë gjykatë. Kërkuesi ka ardhur në dijeni të procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë vetëm gjatë seancës së kundërshtimit të veprimeve përmbartimore nga pala e paditur ku ai ka cilësinë e palës së tretë.

6.1.2. *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë është sjellë si gjykatë fakti në kundërshtim me nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), sepse ka tejkaluar kompetencën e saj të kontrollit të ligjshmërisë, duke shqyrtuar provat.

6.1.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë nuk mund të vihet në diskutim. Ky vendim është vënë në diskutim nga një prej anëtarëve të atij Kolegji, konkretisht relatorja duke dalë me mendim pakice.

6.1.4. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë në arsyetimin e saj nuk përmend asnjë nen të Kodit Civil dhe në këtë mënyrë ajo ka krijuar ligj, në vend që sipas detyrave që ka, duhet të zbatojë ligjin.

6.1.5. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi duke qenë se tashmë çështja vijon të gjykohet prej shumë vitesh dhe me vendimin aktual do të vazhdojë edhe për një periudhë tjetër.

6.2. *Parimi i drejtësisë efektive*, pasi Gjykata e Lartë, kthen për rigjykim çështjen pas 14 vjetësh, ndërkohë që mund ta zgjidhte vetë. Kthimi për rigjykim bëhet vetëm në rastet e parashikuara në nenin 467 të KPC-së dhe jo kur ajo gjykatë ka rezerva për mënyrën e vlerësimit të provave.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuessit*

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1,

shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Lidhur me legjitimitimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke mbajtur parasysh për sa më sipër, nga aktet e vëna në dispozicion, Kolegji çmon se kërkuesi është trashëgimtar i të paditurit A.T. dhe, si i tillë, provon interesin e tij në çështjen objekt shqyrtimi. Në këtë kontekst, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*.

9. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë. Në kushtet kur kontrolli kushtetues ka një funksion subsidiar, ai mund të kërkohej vetëm për një vendim përfundimtar të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor të themelit. Cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, Kolegji evidenton se objekti i ankimit kushtetues individual është shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si gjykatë kompetente nga pikëpamja lëndore, për shkak të nevojës për hetimin dhe vlerësimin e disa rrethanave të pashqyrtuara plotësisht nga gjykatat e faktit.

11. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se vendime të këtij lloji nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste, kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, kërkuksi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimet nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kontrollit kushtetues mund t’i nënshtrohen edhe vendime të tilla me natyrë jopërfundimtare, që jepen gjatë një procesi gjyqësor, nëse plotësohen disa kriteret që lidhen me pasojat e drejtpërdrejta ndaj së drejtës kushtetuese të individit. Në të tilla raste kërkuksi duhet të provojë se shkelja e pretenduar në rastin konkret është e tillë që justifikon shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues, pasi ajo dhe pasojat e saj janë të tilla që nuk mund të riparohen më gjatë rigjyimit të çështjes, pra në procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në juridiksionin e zakonshëm (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, fillimisht, Kolegji vëren se me vendimin objekt kundërshtimi të Gjykatës së Lartë ka përfunduar gjykimi në atë shkallë, por jo procesi gjyqësor, i cili, sipas urdhërimit të asaj gjykate, duhet të ribëhet edhe njëherë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Kërkuksi, lidhur me gjykimin në Gjykatë të Lartë, ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me mbrojtjen efektive, parimin e gjykatës së caktuar me ligj, parimin e sigurisë juridike, standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimin e drejtësisë efektive. Për nga natyra e tyre këto pretendime të ngritura nga kërkuksi mund të shqyrtohen dhe sqarohen gjatë rigjyimit të çështjes në gjykatën e apelit duke marrë përgjigje prej saj në ushtrim të juridiksionit të asaj gjykate. Kjo do të thotë se kërkuksi ka ende mjete juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë. Gjithashtu, për sa u takon pretendimeve që lidhen me mënyrën e disponimit të Gjykatës së Lartë, kërkuksi nuk ka arritur të provojë se shkeljet e pretenduara, në rastin konkret, janë të tilla që justifikojnë shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkuksi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

13. Kolegji vëren gjithashtu se nëpërmjet ankimit kushtetues individual kërkuksi ka ngritur pretendime edhe për kohëzgjatjen e procesit të tij prej shumë vitesh. Në këtë kuadër, sillen në vëmendje ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, ku është përcaktuar, ndër të tjera, se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3), cila është gjykata

kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshejtimin e procedurave (nenet 399/4 dhe 399/6), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7). Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se këto mjete ligjore për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se kërkuesi nuk i ka bashkëlidhur ankimit kushtetues individual ndonjë akt që të provojë se ka përdorur këto mjete ligjore që ka pasur në dispozicion. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion as për pretendimin për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

15. Në kushtet kur ky kriter paraparak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

16. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.